



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31.1.2025

Nr: 49

Ora:12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË MINISTRISË SË
EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT, PËR PERIUDHËN 19 JANAR – 25
JANAR 2025

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 19-25 janar 2025, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Në datën 19.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 23.1.2025, ora 15.00, në njësinë Administrative Nr. 2, me tematikë “Konference/sumit”, “Ekonomi”, “Ambasada izraelite organizon shfaqjen e filmit për Holokaustin, te Teatri i Operës dhe Baletit’.

Data: 31.1.2025 Nr: 49
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 20.1.2025, ora 10.00, “Event i organizuar në Bruksel, në datë 15-16 janar nga Bashkimi Evropian për Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian, ku u diskutua për marrëdhëniet BE-Shqipëri dhe rolin e bizneseve si dhe partnereve sociale dhe të shoqërisë civile, në procesin e integritit të Shqipërisë në BE”.

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: “Në lidhje me veprimtarinë me tematikë “Konferencë/sumit”, event i parashikuar do të raportohet ditë të shtunë, përkatësisht datë 18.01.2025, brenda afatit. U raportua me vonesë pasi faqja e KQZ-së për raportim aktivitetesh, për arsye teknike, nuk komunikonte me serverin për të kryer raportimin. Është provuar disa herë në datë 18.01.2025 dhe 19.01.2025.

Në lidhje me veprimtarinë me tematikë “Event i organizuar në Bruksel...” zv. Ministria, znj. Olta Manjani ka qenë e ftuar për të marrë pjesë në këtë event.

Referuar veprimtarisë me tematikë “Konferencë/sumit” e cila është raportuar jashtë afatit, në rastet kur institucioni e ka të pamundur aksesimin në ndërfaqe, mund të dërgojë raportimin nëpërmjet email-it zyrtar për të respektuar afatin ligjor.

Referuar pikës 3, të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, veprimtaritë ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë, nuk mbartin detyrimin për raportim.

Në përfundim të shqyrtimit, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, veprimtaria me tematikë “Event i organizuar në Bruksel”, është raportuar jashtë afatit ligjor, pasi pjesëmarrësit e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit kanë qenë në cilësinë e të ftuarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI